Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-74
Datë 12.02.2019

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.02.2019 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet Studio Pink Akademy, me adresë, rruga "12 Qershori", Ferizaj, për periudhën 05.02.2019 deri 05.02.2021 me kualifikimet:

   1.1. Grimier/Grimiere, Niveli III sipas KKK me 25 kredi të AAP

   1.2. Manikyrist / Manikyriste, Niveli III sipas KKK me 10 kredi të AAP

   1.3. Pedikyrist / Pedikyriste, Niveli III sipas KKK me 6 kredi të AAP

2. Validohet dhe akreditohet "Studio Pink Akademy" me këto lokacione, Ferizaj, rruga "12 Qershori", Shtime, rruga "Adem Jashari" nr. 148, dhe Viti, rruga "28 Nëntori", p.n. për periudhën 05.02.2019 deri 05.02.2021 me kualifikimin:

   2.1. Parukier/Parukiere, Niveli III sipas KKK me 110 kredi të AAP

3. Numri i kandidatëve që lejohet për grup duke u bazuar në hapësirën fizike, në pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik për secilin kualifikim është:

   3.1. Grimier/Grimiere 8 kandidatë

3.2. Manikyrist/Manikyriste 6 kandidatë

3.3. Pedikyrist / Pedikyriste 6 kandidatë

3.4. Parukier/Parukiere 15 kandidatë në lokacionin në Ferizaj

3.5. Parukier/Parukiere 12 kandidatë në lokacionin në Shtime dhe Viti

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, raporti i vlerësimit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara, rekomandimeve që bazohen në dëshmi dhe dokumentet e ofruara: Aplikacioni për validim të kualifikimit/modulit; aplikacioni për akreditim si institucionit ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; raporti i vetë-vlerësimit; vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumentet tjera shtesë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

4. Vendimi i dërgohet:

- Studio Pink Akademy
- AKK

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema